Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: Të kuptoj bazat e elektronikës brenda fushës së inxhinierisë elektrike; Të kuptoj qarqet e diodave dhe modelet; Të kuptoj qarqet me transistor bipolar dhe FET si dhe modelet e tyre;

Të analizoj qarqet me transistor për sinjale të vogla; Të analizoj dhe shfrytëzoj amplifikatorët operacional; Të përcjellë kurse të avancuara nga elektronika dhe qarqet elektrike.

Përmbajtja e lëndës: Konceptet themelore, rryma tensioni, ligjet e Kirchoff-it, teorema e Norton-it dhe

teorema e Thevenin-it. Qarqet alternative, ekuacionet, rezonanca, funksioni transfer, qarqet me katër pole,

filtrat dhe amplifikatorët. Qarqet me dioda, zener dioda, drejtuesit, dhe qarqet e ndryshme me dioda për

përpunimin e sinjalit. Transistorët bipolar, konfiguracionet themelore të qarqeve me transistor bipolar,

modelet për sinjale të vogla. Konfiguracionet themelore të amplifikatorëve: me emiter të përbashkët, me bazë të përbashkët dhe me kolektor të përbashkët. Transistori me efekt të

fushës, parimet e punës, modelet për sinjale të vogla. Transistorët MOSFET. Konfiguracionet themelore të amplifikatorëve: me surs të përbashkët, me gej të përbashkët dhe me drejn të përbashkët.

Amplifikatorët operacional, karakteristikat ideale dhe reale, qarqet themelore me amplifikator operacional, zbatimet e AO. Elementet e riveprimit, amplifikatori diferencial.

Mbledhja e të dhënave dhe kontrolli i proceseve, komparatorët, oscilatorët,

shndërruesit A/D, shndërruesit D/A, shndërrimi i kohës. Kompjuterët dhe ndërlidhja e qarqeve.

Metodologjia e mësimdhënies:

30 orë ligjërata, 15 orë ushtrime numerike dhe 15 orë ushtrime laboratorike. Afërsisht 100 orë pune të pavarur.

Vlerësimi: Metodatat e vlerësimit: • Vlerësimi i parë: 15 % • Vlerësimi i dytë: 15 % • Vlerësimi final: 20% • Provimi final: 50%

Literatura bazë :

1. Donald Neamen, Electronic Circuit Analysis and Design, McGraw-Hill Education, 2000,
2. Adel S. Sedra, Kenneth C. Smith, Microelectronic Circuits, Oxford University Press, 2007,
3. Myzafer Limani, Elektronika, Universiteti i Prishtinës, ligjërata të autorizuara, 2008.

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :Matjet elektrike (Obligative, Sem III, 5 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Qëllimi i kursit është të prezantojnë njohuritë themelore të matjeve elektrike.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të aftësohet për përdorimin e: Instrumenteve dhe metodave të matjeve të madhësive elektrike dhe joelektrike si dhe magnetike. Ai do të jetë në gjendje që këto ti realizon në mënyrë shkencore dhe profesionale duke e çmuar edhe pasigurinë e rezultatit të matjes. Brezi i madhësive të matura i mbulon kërkesat në industri dhe prodhim si dhe në kërkime pa i përfshi matjet speciale, d.m.th do të ketë njohuri për sensorët, amplifikatorët dhe konvertorët e madhësive.

Përmbajtja e lëndës: Njësitë matëse dhe gabimet e matjes. Ta din përdorimin e kombinimeve të rezistorëve për realizimin e skemave matëse si: ndarësit e tensionit-potenciometrat, dhe të rrymës, të kompensatorëve si dhe të urave matëse. Ti njeh termoçiftet, termorezistorët, termistorët si dhe sensorët rezistiv për matjen e temperaturës dhe të sforcimeve mekanike. Të ketë njohuri për përdorimin e sensorëve: kapacitiv, induktiv, magnetik dhe elektromagnetik si me induksion elektromagnetik për matjen e madhësive të ndryshme fizike dhe elektrike. Të aftësohet për metodat dhe për instrumente për matjen e madhësive elektrike: tensionit, rrymës-të vazhduar dhe alternative, rezistencës, impedancës

dhe reaktancës; fuqisë dhe energjisë si në qarkun e rrymës së vazhduar ashtu edhe alternative-njëfazore dhe trefazore. Të aftësohet për metodat dhe për instrumente për matjen e madhësive magnetike (fluksit, induksionit, intensitetit të fushës dhe humbjeve në hekur).

Metodologjia e mësimdhënies: 45 orë ligjërata, së bashku me shembuj numerik dhe 30 ushtrime laboratorike. Afërsisht 75 orë pune me ligjëruesin dhe asistentët.

Vlerësimi: Vlerësimet nga 3 testet nga 15 %, nga testi laboratorik 15% dhe provimi final 40 %.

Literatura bazë :

1. A. Gashi, Matjet elektrike, ligjëratat dhe prezantimet 2012.
2. M.J. KORSTEN, W. OTTHIUS, F. VAN DER HEIJDEN “Measurement Science for Engineers, Elsevier Science & Technology Books, 2004.
3. M. SEDLÁČEK, V. HAASZ, Electrical Measurements and Instrumentation, Prague 2000.

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :Arkitektura e Kompjuterëve (Obligative, Sem IV, 5 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Qëllimi i kursit është të paraqesë arkitekturën dhe organizimin e kompjuterëve, strukturën dhe funksionimin e tyre.

Rezultatet e pritura të nxënies : Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti duhet të jetë në gjendje që: 1. Të pajiset me njohuritë e evoluimit të kompjuterëve, zhvillimin e tyre gjatë gjeneratave, bus-at e sistemit, memoriet e të gjitha llojeve, modulet hyrëse dalëse, instruksionet, modet e adresimit, formatet e adresimit, ndërtimin e procesorit, si dhe ndërtimin e procesorëve modern. 2. Të jetë në gjendje të shkruajë dhe ekzekutojë programe në gjuhën Asembler, duke përdorur regjistrat. 3. Të jetë në gjendje të vlerësojë performansën e punës së një kompjuteri. 4. Të njohë kërkesat dhe parametrat e dizajnit të procesorit, memorieve dhe kompjuterëve në përgjithësi.

Përmbajtja e lëndës: Evoluimi i Kompjuterëve. Performansa e kompjuterëve. Bus-at. Memoret kesh. Memoret e brendëshme. Memoret e jashtme. Modulet Hyrëse/Dalëse. Aritmetika kompjuterike. Gjuha Asembler. Mikroprogramimi. Setet e instruksionit. Modet dhe formatet e adresimit. Struktura dhe funksioni i procesorit. Procesorët RISC dhe CISC.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata, 30 ushtrime (numerike dhe laboratorike). Afërsisht 80 orë pune të pavarur përfshirë punimet e projekteve të pavarura .

Vlerësimi: Vlijueshmëria 10%, Vlerësimet e punimeve (projekteve) 30 %, Provimi final 60 %

Literatura bazë :

1. Williams Stallings “Computer Organization and Architecture – Designing for Performance”, 8th Edition, Prentice Hall, 2010
2. Linda Null and Julia Lobur, “The essentials of Computer Organization and Architecture”, Jones and Bartlett Publishers, 2003

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :Elektroenergjetika (Obligative, Sem IV, 6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Qëllimi i kursit është të prezantojparimet themelore të funksionimit të sistemit elektroenergjetik dhe makinave elektrike.

Rezultatet e pritura të nxënies : Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të ketë njohuri për sistemin elektroenergjetik, pjesët përbërëse të tij (centralet, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, nënstacionet).
2. Të ketë njohuri për transformatorët, parimin

e punës, skemat ekuivalente, llojet e transformatorëve dhe përdorimin e tyre. 3. Të njohë principet e shndërrimit të energjisë, parimin e punës së makinave të rrymës së vazhduar. 4. Të njohë principet e punës së makinave të rrymës alternative me theks të veçantë të motorit asinkrone dhe generatorit sinkrone.

Përmbajtja e lëndës: Sistemi elektroenergjetik dhe pjesët përbërëse të tij. Centralet elektrike, sistemi transmetues dhe sistemi shpërndarës. Termocentralet, centralet nukleare, hidrocentralet, centralet me erë, centralet diellore. Analiza e qarqeve njëfazore dhe trefazore. Linjat transmetuese dhe kabllo. Parimet e shndërrimit të energjisë. Parimi i punës së transformatorit, skemat ekuivalente, shqyrtimet në transformator. Parimi i punës së makinave të rrymës së vazhduar. Llojet e eksitimit. Rregullimit i tensionit dhe shpejtësisë. Modeli i makinave të rrymës alternative. Parimi i punës së makinave asinkrone. Skema ekuivalente, Fem, momenti dhe lëshimi në punë i motorit asinkron. Parimi i punës së makinave sinkrone.

Metodologjia e mësimdhënies: 45 orë ligjërata, 30 ushtrime numerike. Afërsisht 100 orë pune të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësimi i parë 20 %, Vlerësimet e dytë 20 %, Provimi final 60 %

Literatura bazë :

1. George G. Karady & Keith Holbert, Electrical Energy Conversion and Transport, John Wiley, 2005.
2. Guru, B.S and Hiziroglu, H.R. Electric Machinery and Transformers, Oxford University Press, New York- Oxford 2001.
3. Gani Latifi, Shndërrimi i energjisë elektrike, Prishtinë 1997
4. Vjollca Komoni, Gani Latifi Elektronenergjetika, ligjëratat, Prishtinë 2008

Emërtimi i lëndës: Fushat dhe valët elektromagnetike (Obligative, Sem. IV, 6 ECTS)

Qëllimi i lëndës: Të pajis studentët me njohuri mbi fushat elektrike dhe magnetike statike dhe të ndryshueshme, bashkëveprimin në mes tyre, si dhe vetitë dhe përhapjen e valëve elektromagnetike në medime të ndryshme.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të sukseshëm të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: 1. Zbatojnë analizën vektoriale për të shqyrtuar fushën elektrike dhe magnetike statike në konfiguracione standarde 2. Shpjegojnë parametrat e fushave kuazistatike dhe atyre të ndryshueshme me kohën, përhapjen e valëve elektromagnetike dhe rolin e ekuacioneve të Maksuellit në këto procese 3. Përshkruajnë shembuj të bashkëveprimit në mes të valëve elektromagnetike dhe medimeve të ndryshme; 4. Ilustrojnë dhe analizojnë linjat transmetuese; 5. Praktikojnë llogaritjen e fushave elektromagnetike për zgjidhjen e problemeve konkrete inxhinierike.

Përmbajtja e lëndës: Analiza vektoriale: Gradienti, Divergjenca, Rotori dhe operatori Laplasian. Elektrostatika: Ekuacionet e Maksuellit, Shpërndarja e ngarkesave dhe rrymave, Ligji Gausit, Potenciali, Vetitë elektrike të medimeve, Metoda e pasqyrit, Energjia potenciale elektrostatische. Magnetostatika: Forcat dhe momenti, Ekuacionet e Maksuellit për magnetostatikë, Potencialet në fushën magnetike, induktiviteti dhe energjia magnetike. Ekuacionet e Maksuellit për fushat e ndryshueshme me kohën: Ligji i Faradejit, rryma e zhvendosjes, potencialet e vonuara. Valët elektromagnetike: Derivimi dhe zgjidhja e ekuacionit të valës TEM, vetitë e valëve të rrafshta, përhapja e valëve në medimet pa dhe me humbje. Linjat transmetuese: Derivimi i parametrave të linjave transmetuese, përhapja dhe dobësimi i valëve në linjë, impedanca karakteristike, impedanca e hyrjes, tipet e linjave si dhe metodat e përshtatjes së linjave.

Metodat e mësimdhënies : 45 orë ligjerata + 15 orë ushtrime të kombinuara. Mesatarisht 80-90 orë mësim vetanak .

Vlerësimi: Detyra 15%, Vlerësimi intermediar 35 %, Provimi final 50 %

Literatura:

1. Fawwaz T. Ulaby, Eric Michielssen and Umberto Ravaioli, “Fundamentals of Applied Electromagnetics” Prentice Hall 6th Edition, 2010
2. Magdy F. Iskander “Electromagnetic Fields and Waves “, Waveland Press, 2012

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :Telekomunikacionet (Obligative, Sem IV. 7 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Qëllimi i kursit është të prezantojparimet themelore të funksionimit të telekomunikimeve analoge dhe digjitale.

Rezultatet e pritura të nxënies : Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të din konceptet themelore në telekomunikacion, duke përfshirë: sinjalet dhe sistemet, mostrimin, proceset e modulimeve analoge, zhurmën dhe efektin e saj, teknikat e konvertimit A/D dhe teknikat e multipleksimit/qasjes së shumëfishtë 2. Të njoh dhe identifikoj karakteristikat kryesore të modulimeve analoge dhe digjitale 3. Të din konceptet themelore në telekomunikimet digjitale, me theks të veçantë në njohjen e kriterëve për përcaktimin e performancës së sistemeve të telekomunikimeve digjitale 4. Të njoh teknikat e transmetimit digjital në brezin themelor dhe atë të zhvendosur 5. Të hartojë një punim lidhur me një problematikë a qështje të caktuar nga fusha e telekomunikacionit

Përmbajtja e lëndës: Modeli i sistemit telekomunikues. Informacioni dhe matja e tij. Analiza spektrore e sinjaleve. Sistemet lineare dhe jolineare. Modulimet analoge. FDM/FDMA. Procesi I mostrimit. Modulimet pulsore. Konvertimi A/D. Modulimi pulsor I koduar (PCM), PCM diferencial, modulimi delta. TDM/TDMA. Analiza e sistemit analog. Modeli i sistemit digjital. Kodimi I burimit. Kriteret e performances dhe limitet e sistemit telekomunikues. Transmetimi digjital në brezin themelor. Kodimi linjor. Interferenca ndërmjet simboleve. Kriteri i Nyquist-it. Teknikat e ekuilizimit të kanalit. Modulimet digjitale. Analiza e sistemit digjital.

Metodologjia e mësimdhënies: 45 orë ligjerata, 15 ushtrime numerike dhe 15 ushtrime laboratorike. Afërsisht 100 orë pune të pavarur përfshirë punimin seminarik .

Vlerësimi: Seminari 10%, Vlerësimet intermediare 30 %, Provimi final 60 %

Literatura bazë :

1. R. E. Ziemer and W. H. Tranter, “Principles of communications”, 5th Ed., John Wiley & Sons Inc., 2002
2. Roger Freeman, “Fundamentals of Telecommunications”, A John Wiley & Sons, inc. publication, 2004
3. HWEI HSU, PH.D. “Analog and Digital Communications” , second edition, Shaum~s outline s series, 2003

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :Menaxhimi i Projekteve (Zgjedhore, Sem IV. 6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Kursi ka për qëllim që t'i njoftoj studentët me konceptet themelore të menaxhimit të projekteve si dhe t'iu ofroj mundësi atyre që përmes ushtrimeve dhe punës praktike të aplikojnë konceptet e mësuara.

Rezultatet e pritura të nxënies : Në fund të këtij kursi, studentet duhet të jenë në gjendje të:

Identifikojnë projektet dhe te bëjnë dallimin nga aktivitetet tjera ne organizate Kuptojnë rëndësinë e planifikimit te projektit dhe aktiviteve qe nevojiten për planifikim te mire. Kuptojnë natyrën komplekse te menaxhimit te aktiviteve te projektit. Përdorin teknika te ndryshme për menaxhim te projektit (si p.sh. PERT). Identifikojnë aftësitë e duhura për një menaxher te suksesshëm te projektit. Kuptojnë konceptet e kosos se projektit, buxhetit te projektit dhe aktiviteve qe nevojiten për menaxhimin e tyre. Identifikojnë dhe menaxhojnë rreziqet e projektit. Kuptojnë rëndësinë e auditimit dhe monitorimit te projekteve.

Përmbajtja e lëndës: Konceptet themelore te menaxhimit te projekteve. Fazat e Projektit- Konceptimi dhe Studimi. Fazat e Projektit- planifikimi dhe zbatimi. Menaxhimi i Ekipeve të projektit. Vlerësimi i kohës dhe kosos. • Planifikimi dhe skedulimi i projektit. Alokimi i resurseve. • Menaxhimi i Riskut • Monitorimi dhe kontrolli i projektit. • Auditimi i projektit.

Metodologjia e mësimdhënies:30 orë ligjërata, 30 ushtrime. Afërsisht 100 orë pune të pavarur përfshirë punimin seminarik .

Vlerësimi: Seminari 20%, Puna seminarike në Wikipedia 10 %, Provimi final 60 %

Literatura bazë :

1. Suzana Panariti: Menaxhimi i Projekteve, Shtëpia Botuese e Librit Universitar 2010, Tirane

Literatura shitesë:

2. Clifford F. Gray, Eric W. Larson: Project Management, The managerial Process, McGraw-Hill, 2006

3. Denis Lock: Project Management, Gower Publishing Limited, 2008

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Teoria e informacionit(Obligative, Sem. V, 6 ECTS)

Qëllimet e kursit: Qëllimi kryesor i këtij kursi është që të njoftojë studentët me aspektet themelore të teorisë së informacionit si dhe t'u ofrojë atyre një pasqyrë për teknikat e ndryshme të kodimit, për kapacitetin e kanalit dhe gjetjen e gabimit përmes metodave të ndryshme të kodimit për kontrollim të gabimeve.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: të njohë nocionet themelore nga teoria e informacioni si dhe teknikat e ndryshme të kodimit; të bëjë krahasimin e situatat reale praktike duke shfrytëzuar si referencë tri teoremat themelore të Shanonit në Teorinë e Informacioni; të jetë në gjendje të realizojë dhe analizojë skema të ndryshme të kodimit optimal dhe të komprimimit të burimit; të jetë në gjendje t'i shfrytëzojë aftësitë dhe shkathtësitë e fituara në këtë kurs për punë të mëtutjeshme kërkimore e shkencore.

Përmbajtja e lëndës: Gjenezja dhe nocioni i teorisë së informacionit;Burimet pa memorie dhe me memorie;Matja e sasisë së informacionit;Modeli i sistemit komunikues;Mesazhet, simbolet dhe sinjalet;Disa veti të probabilitetit;Ngjarjet e rastit dhe sasia e informacionit;Modeli i sistemit;Informacioni reciprok; Entropia dhe vetitë e entropisë;Kapaciteti i kanalit;Kodimi dhe entropia; Kodimi entropik; Metodatat e komprimimit; Llojet e kodeve; Kodimi optimal; Jobarazimi i Krafit;Metodat e kodimit entropik; Kodimi i Shanon-Fanos;Kodimi i Hafmanit;Kodimi aritmetikor;Metodat e fjalorit;Metodat e shkurtimit të vargut;Kodimi burimor;Metodat themelore të kodimit burimor;Kuantizimi; Nënmostrimi; Kodimi me transformim;Kodimi diferencial; Kodimi i bazuar në model;Kapaciteti i kanalit me zhurmë të gausit; Hyrje në kodet për detektim dhe për korrigjim të gabimeve;Kodimi linear i blloqeve;Gjetja e gabimit me metodën e kontrollimit të paritetit.

Metodologjia e mësimdhënies: ligjërata, diskutim, detyra projektuese.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimi i parë: 20%, Vlerësimi i dytë: 20%, Detyra projektuese: 10%. Vijimi i rregullt 5%, Provimi final: 35%

Literatura bazë:

1. Essentials of Error-Control Coding, Jorge Castiñeira Moreira, Patrick Guy Farrell, 2006 John Wiley & Sons Ltd.
2. Telecommunications Demystified, Carl Nassar, by LLH Technology Publishing, 2001.

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Përpunimi digjital i sinjaleve(Obligative, Sem. V, 6 ECTS)

Qëllimet e kursit (modulit): Thëllim i njohurive për analizë të sinjaleve dhe sistemeve diskrete. Njohja me strukturat e sistemeve diskrete. TDF, FFT, përpunimi me shumëshpeshtësi. Projektimi i filtrave digjital, IIR dhe FIR. Hyrje në përpunimin e sinjaleve diskrete të rastit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit ë kësaj lënde studenti duhet të jetë në gjendje që: Të kuptoj dhe të zbatoj metodat e ndryshme për analizë të sinjaleve dhe sistemeve diskrete, si në domenin kohor ashtu edhe në atë frekuencor. Të kuptoj thurjen rrethore dhe lidhje e saj me thurjen lineare dhe si ta përfitoj thurjen lineare për transformimit diskret Furie. Të zotëroj metodat projektues për filtra digjital (IIR dhe FIR). Të kuptoj sistemet me shumëshpeshtësi dhe përpunimin e sinjaleve me shumëshpeshtësi. Të kuptoj parimet bazë të përpunimit të sinjaleve diskrete të rastit.

Përmbajtja e lëndës: Sinjalet dhe sistemet diskrete, përgjigja impulsive, thurja, ekuacionet e diferencës, korrelacioni. Transformimi Furie në kohë diskrete dhe mostrimi. z-transformimi. Transformimi diskret Furie. Strukturat për implementim të sistemeve diskrete. Projektimi i filtrave digjital, rekursiv dhe jo-rekursiv. Përpunimi me shumëshpeshtësi i sinjaleve. Sinjalet e rastit dhe sistemet lineare, hyrje në filtrimin optimal.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata, 30 ushtrime. Afërsisht 75 orë pune të pavarur.

Vlerësimi: Detyrat e shtëpisë 10%, Vlerësimet e ndërmjetme 30 %, Provimi final 60 %.

Literatura bazë :

1. Discrete -Time Signal Processing”, Alan V. Oppenheim, et al, 2nd ed., 1998, Prentice Hall.
2. “Schaum's Outline of Theory and Problems of Digital Signal Processing”, Monson H. Hayes, McGraw-Hill, 2011.
3. “Digital Signal Processing - Principles, Algorithms and Applications”, John G. Proakis and Dimitris G. Manolakis; 3rd ed., 1996, Prentice Hall.

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : Mikrovalët dhe antenat (Zgjedhore, Sem,V. 6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Të zhvilloj njohuritë bazë si dhe metodat për analizën e elementeve mikrovalore, qarqeve mikrovalore dhe antenave , të cilat zbatohen në sistemet moderne të komunikimeve patela në brezin 0.3-300 GHz.

Rezultatet e pritura të nxënies : Pas përfundimit të këtij kursi (lëndë) studenti do të jetë në gjendje që: 1. Të jetë i familjarizuar me konceptet themelore në mikrovalë, inxhinieri mikrovalore dhe antena 2. Të din të shfrytëzoj vegla të ndryshme për analizën dhe projektimin e elementeve dhe qarqeve për përshtatje në frekuenca të larta, sic është diagrami i Smith-it 3. Të din funksionimin e qarqeve mikrovalore me përdorimin e S-parametrave . 4. Të njoh parametrat themelor të antenave si dhe funksionimin e tyre 5. Të hartojë një punim lidhur me një problematikë a qështje të caktuar nga fusha e mikrovalëve dhe antenave

Përmbajtja e lëndës: Karakteristikat themelore të sistemeve të radio komunikimeve. Linjat transmetuese. Diagrami I Smith-it dhe S-parametrat. Veglat CAD. Elementet mikrovalore dhe rrjetet mikrovalore në teknikën e linjave mikroshiritore. Valëprcjellsit dhe elementet përkatëse mikrovalore. Karakteristikat themelore dhe parametrat e antenave.: zona e rrezatimit, intensiteti i rrezatimit, diagram i rrezatimit, drejtueshmëria, përforcimi, polarizimi, etj. Antenat mikrovalore. Vargu i antenave.

Metodologjia e mësimdhënies:45 orë ligjërata dhe 30 orë ushtrime numerike. Rreth 90 orë punë e pavarur, përfshirë punimin e seminarit.

Vlerësimi:Seminari 10%, Vlerësimet intermediare 30 %, Provimi final 60 %

Literature:

1. D. M. Pozar, Microwave and RF Design of Wireless Systems, John Wiley & Sons, 2001
2. Kai Chang, Radio Frequency Circuit Design, John Wiley & Sons, 2001
3. E. Hamiti, Mikrovalët dhe antenat, ligjërata të autorizuara, Prishtinë 2009

Titulli i kursit (lëndës mësimore): **Komunikimet mobile** (Zgjedhore, Sem V, 6 ECTS)

Qëllimi i lëndës mësimore: Qëllimi i kësaj lëndës mësimore është paisja e studentëve me njohuri të domosdoshme mbi konceptet themelore, principet dhe sistemet komunikuese mobile.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të kësaj lënde mësimore, studenti:

1. Do të posedoi njohuri solide për principet themelore si dhe për teknologjitë e shumëllojshme të komunikimeve mobile. 2. Do të posedoi njohuri solide për transmetimin pa tela. 3. Do të posedoi njohuri solide për llojet e multipleksimit dhe të qasjes së shumëfishtë të përdorura në sistemet e komunikimeve mobile. 4. Do të posedoi njohuri solide për arkitekturën e sistemeve komunikuese mobile: GSM, GPRS, UMTS, LTE, WiMAX, WLAN, satelitore 5. Do të posedoi njohuri solide për menaxhimin e mobilitetit në rrjetet komunikuese mobile.

Përmbajtja e lëndës: Hyrje për komunikimet mobile. Komponentet e sistemit komunikues pa tela. Transmetimi pa tela: ndikimi i mediumit pa tela, koncepti dhe llojet e mobilitetit, frekuencat e përdorura, përhapja e sinjalit, modulimet dhe antenat. Konceptet themelore të komunikimeve mobile celulare: celula, stacioni bazë, ripërdorimi i frekuencave, menaxhimi i mobilitetit. Llojet e modulimeve: PSK, QPSK, QAM, DSSS, OFDM. Llojete qasjes së shumëfishtë: Slotted Aloha, CSMA/CA, FDMA, TDMA, CDMA, OFDMA. Sistemet komunikuese pa tela: rrjetet mobile celulare tokësore (GSM, GPRS, UMTS, LTE), teknologjia WiMAX, rrjetet WLAN, rrjetet satelitore.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata, 15 ushtrime numerike dhe 15 ushtrime me kompjuter. Afërsisht 100 orë pune të pavarur përfshirë seminarin.

Vlerësimi:Seminari 15%, Vlerësimet intermediare 30 %, Provimi final 55 %

Literatura bazë :

1. F. Molisch, “Wireless Communications”, Second Edition, John Wiley & Sons Ltd., 2011.
2. S.Lepaja, Mobility and QoS in Global Broadband Communication Networks, Ph.D. Dissertation, TU WIEN, March 2005.
3. J. Schiller, Mobile Communications, Addison-Wesley, 2000.

Emërtimi i lëndës: Hyrje në bioelektromagnetikë(Zgjedhore , Sem. V, 6 ECTS)

Qëllimi i lëndës: Pajisja e studentëve me njohuri të përgjishme për bashkëveprimin në mes të fushës elektromagnetike dhe trupit të njeriut

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës studentët do të jenë në gjendje të:1 Definojnë konceptet bazike të bioelektromagnetikës; 2. Shpjegojnë mekanizmat dhe parametrat që cilësojnë bashkëveprimin në mes të fushës elektromagnetike dhe njeriut;

3. Krahasojnë raste të ndryshme të ekspozimit të njeriut në fushë elektromagnetike; 4.Vlerësojnë nivelin e ekspozimit me standardet dhe limitet ndërkombëtare të sigurisë; 5. Demonstrjnë njohuri për vlerësimin eksperimental të nivelit të ndotjes elektromagnetike

Përmbajtja e lëndës: Bioelektromagnetika: Definicioni dhe fundamentet. Konceptet bazike të fushave dhe valëve elektromagnetike: Ekuacionet e Maksuellit, spektri elektromagnetik, ekuacioni dhe vetitë e valëve elektromagnetike. Mekanizmat e ndërlidhjes në mes të fushës elektromagnetike dhe trupit të njeriut. Vectoritë elektromagnetike të shtresave biologjike: permitiviteti, permeabiliteti dhe përcueshmëria. Fuqia e absorbimit specifik: energjia e depozituar nga fusha elektromagnetike në trupin e njeriut. Bashkëveprimi në mes të fushës elektromagnetike të frekuencave të ulëta dhe trupit të njeriut, bioefektet e ekspozimit. Bashkëveprimi në mes të fushës elektromagnetike të frekuencave të larta dhe trupit të njeriut, bioefektet e ekspozimit . Standardet dhe limitet ndërkombëtare të sigurisë: IEEE, ICNIRP, CELNEC. Raste studimore: Linjat për bartjen e energjisë dhe shëndeti publik, Telefoni celular dhe shëndeti i njeriut etj

Metodat e mësimdhënies : 30 orë ligjerata + 15 orë ushtrime laboratorike. Mesatarisht 80-90 orë punë vetanake përfshirë detyrat.

Vlerësimi: Detyrat 30%, Vlerësimi intermediar 30 %, Provimi final 40 %

Literatura:

1. Cynthia Furse, “ Basic Introduction to Bioelectromagnetics” CRC Press, 2010
2. Riadd Habash, “Electromagnetic Fields and Radiation : Human Bioeffects and Safety“, CRC Press, 2001
3. Luan Ahma, Mimoza Ibrani “ Hyrje në bioelektromagnetike”, dispenca, UP, 2010

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :Ndërmarrësia (Zgjedhore, Sem V, 6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Kursi ka për qëllim t'i njoftojë studentet me konceptet baze të inovacionit dhe ndërmarrësisë me qëllim të stimulimit të menduarit dhe vepruarit ndërmarrës

Rezultatet e pritura të nxënies : Në fund të këtij kursi, studentet duhet të jenë në gjendje të: Kuptojnë konceptet e ndërmarrësisë dhe inovacionit. Kuptojnë se si këto koncepte ndryshojnë nga menaxhmenti klasik. Kanë njohuri bazë për teorinë kryesore të ndërmarrësisë dhe inovacionit. Kanë njohuri për kërkesat për fillimin e një biznesi. Njohin shtyllat bazë të biznes modeleve. Kuptojnë burimet e ndryshme të financimit të bizneseve. Kuptojnë përdorimin e teknologjisë dhe ndikimin e internetit në ndërmarrësi. Janë të njoftuar me përvojat dhe rastet e studimit nga përditshmëria e ndërmarrësve të suksesshëm në Kosovë.

Përmbajtja e lëndës: Praktika e inovacionit dhe ndërmarrësia sistematike. Praktika e ndërmarrësisë. Strategjitë Ndërmarrëse. Korniza e Modelit të biznesit. Modelet karakteristike të bizneseve. Teknikat për dizajnimin e modeleve të biznesit. Strategjia e biznesit bazuar në kornizën e modelit të biznesit. Proceset për dizajnimin e biznes modeleve inovative. Shembuj të biznes modeleve dhe aplikimit të kornizës së modelit të biznesit.

Metodologjia e mësimdhënies:30 orë ligjerata, 30 ushtrime. Afërsisht 100 orë pune të pavarur përfshirë punimin seminarik . Gjatë ushtrimeve një rol të rëndësishëm luajnë

ligjëruesit mysafir që janë ndërmarrës të suksesshëm në Kosovë ose përfaqësueses të institucioneve që përkrahin dhe promovojnë ndërmarrësinë.

Vlerësimi:Plani i biznesit (punimi seminarik) 40%, Provimi final 60 %

Literatura bazë :

1. Peter F. Drucker: Inovacioni dhe Ndërmarrësia, Shtëpia Botuese e Librit Universitar 2010, Tirane
2. Alexander Oswalder dhe Yves Pigneur: Business Model Generation, John Wiley and Sons, 2010.

“Sistemet Telekomunikuese”

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Sisteme transmetuese(Obligative, Sem. VI. 6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Qëllimi kryesor i këtij kursi është që të njoftojë studentët me sisteme të ndryshme të transmetimit dhe t’u ofrojë atyre një pasqyrë për teknikat dhe teknologjitë aktuale. Qasje për këtë qëllim përfshin të dy aspektet – atë të transmetimit dhe të rrjeteve të telekomunikacionit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

Të njohë sisteme të ndryshe të transmetimit si dhe teknikat përkatëse të realizuara në teknologji moderne; Të bëjë përshkrimin dhe të dallojë përparësitë dhe të metat e teknikave dhe teknologjive të sistemeve të ndryshme të transmetimit; Të projektojë dhe të realizojë rrjete të telekomunikacionit dhe sisteme të ndryshme transmetuese; Të jetë në gjendje që aftësitë dhe shkathtësitë e fituara në këtë kurs t’i shfrytëzojë për punë të mëtutjeshme kërkimore e shkencore.

Përmbajtja e lëndës: Rëndësia e telekomunikimeve; Zhvillimi historik dhe standardizimi, Zhvillimi i bizneseve telekomunikuese; Rrjetet telekomunikuese– Pasqyrë e përgjithshme; Numeracioni telefonik; Rrjeti lokal për akses; Rrjeti rajonal; Rrjeti ndërkombëtar; Rrjetet telekomunikuese; Menaxhimi i rrjeteve telekomunikuese; Llojet e informacionit dhe kërkesat e tyre; Nocionet themelore të një sistemi transmetues; Mediumet transmetuese me përçues metalik; Komunikimet optike; Kabllot me fibra optikë; Shpërndarja dhe zbatimi i spektrit elektromagnetik; Modelet e përhapjes; Dobësimi i radio valëve në hapësirë të lirë; Antenat; Radio transmetimi; Sistemet mikrovalore radio-rele; Transmetimi satelitor; Drita ultra e kuqe; Drita laserike; Degradimet e sinjalit gjatë transmetimit; Transmetimi i sinjaleve digjitale në largësi; Kodimi linjor; Transmetimi i të dhënave; Multiplekserët dhe koncentratorët; Multipleksimi optik; Komunikimet mobile; Parimi i funksionimit të një rrjeti celular.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratë, diskutim, detyra projektuese.

Vlerësimi: Vlerësimi i parë: 20%, Vlerësimi i dytë: 20%, Detyrat projektuese: 20%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 35%

Literatura bazë :

1. Introduction to Telecommunications Network Engineering, Tarmo Anttalainen, Second Edition, Artech House.
2. Optical Fiber Communications, John M. Senior, Third edition, Prentice Hall.
3. Telekomunikacionet, Ardian Shehu, Libri Universitar.

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : Qarqet komunikuese analoge (Obligative, Sem V, .6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Të zhvilloj njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për analizën dhe projektimin e qarqeve elektronike të frekuencave të larta, të cilat zbatohen në komunikime në frekuenca të larta.

Rezultatet e pritura të nxënies : Pas përfundimit të këtij kursi (lëndë) studenti do të jetë në gjendje që: 1. Të analizoj dhe projektojë filtrat, amplifikatorët e frekuencave të larta dhe qarqet për përshtatje me përdorimin e S-parametrave. 2. Të din të shfrytëzoj vegla të ndryshme për analizën dhe projektimin e qarqeve në frekuenca të larta 3. Të njoh dhe përshkruaj funksionimin e qarqeve të avancuara të frekuencës së lartë, sic janë: PLL-të, sintetizuesit e frekuencës, mikserët, oscilatorët, etj.4. Të hartojë një punim lidhur me një problematikë a qështje të caktuar nga fusha e qarqeve analoge komunikuese .

Përmbajtja e lëndës: Njohuri të përgjithshme për sistemet e komunikimeve patela. Linjat transmetuese dhe përdorimi i diagramit të Smith-it. Analiza e rrjeteve në frekuenca të larta. Qarqet për përshtatje. Filtrat. Analiza dhe projektimi i amplifikatorëve në frekuenca të larta. Mikserat. PLL qarqet. Oscilatorët me transistor dhe sintetizuesit e frekuencës.

Metodologjia e mësimdhënies:45 orë ligjërata dhe 30 orë ushtrime numerike. Rreth 90 orë punë e pavarurë, përfshirë punimin e seminarit.

Vlerësimi:Seminari 10%, Vlerësimet intermediare 30 %, Provimi final 60 %

Literatura:

1. D. M. Pozar, **Microwave and RF Design of Wireless Systems**, John Wiley & Sons, 2001

2. Kai Chang, Radio Frequency Circuit Design, John Wiley & Sons, 2001

3. E. Hamiti, **Qarqet komunikuese analoge**, ligjërata të autorizuar, Prishtinë 2009

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : Sistemet komutuese (Obligative, Sem VI, 6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Qëllimi i kursit është që studentët të njihen me konceptin e komutimit, pozitën, arkitekturën, funksionimin, shërbimet dhe operimin e Sistemeve komutuese në llojet e ndryshme të rrjeteve telekomunikuese.

Rezultatet e pritura të nxënies : Pas përfundimit të këtij kursi (lëndë) studenti do të fitojë njohuri për:

1. Konceptin e komutimit, zhvillimin e teknologjisë së komutimit nga centralet e para manuale analoge e deri te sistemet komutuese dixhitale të sotme; 2. Parimin e funksionimit të dy teknikave kryesore të komutimit: komutimit të kanaleve (qarqeve) dhe komutimit të paketave, vetitë, përparësitë dhe të metat e tyre; 3. Parimin e funksionimit të komutimit në kohë dhe në hapësirë si dhe llojet e kombinimit të tyre për ndërtimin e fushave komutuese të përdorura në sistemet komutuese bashkëkohore; 4. Arkitekturën funksionale, harduerike dhe softuerike të një sistemi komutuese dixhital të përgjithësuar (gjenerik) dhe të paramenduar (hipotetik), funksionin, nivelet dhe hierarkinë e kontrollit të tyre; 5. Ndërlidhjen e sistemeve komutuese përmes ndërfaqeve, konceptin e sinjalizimit dhe komunikimin ndërmjet tyre përmes sinjalizimeve; 6. Shërbimet e ofruara nga sistemet komutuese dixhitale; 7. Konceptet kryesore të trafikut telekomunikues dhe shfrytëzimin e teknikave dhe formualve të llogaritjes dhe matjes së ngarkesës së trafikut për dimenzionimin dhe mbikqyrjen e funksionimit të sistemeve komutuese dixhitale; 8. Parimin e funksionimit dhe sfidat për përcjelljen e zërit dhe komunikimit interaktiv në rrjete me komutim të paketave (VoIP). Do të njihet me rrjetin NGN, arkitekturën e tij, elementet funksionale dhe protokollet kryesore të përdorura. Në vecanti do të njihet me Softswitch-in si elementin qendror komutues në rrjetet e ditëve të sotme.

Përmbajtja e lëndës: Hyrje në komutim, historiku i zhvillimit të Sistemeve komutuese nga centralet telefonike manuale deri te sistemet SPC. Arkitektura e Sistemeve komutuese dixhitale, nivelet dhe hierarkia e udhëheqjes dhe komunikimit; Softueri i Sistemeve komutuese dixhitale; Ndërfaqet dhe sinjalizimet në Sistemet komutuese dixhitale; Shërbimet e ofruara nga Sistemet komutuese dixhitale; Teknikat e llogaritjes dhe matjes së trafikut në Sistemet komutuese dixhitale; Parimi i përcjelljes së zërit në rrjetet me komutim të paketave (VoIP). Arkitektura dhe karakteristikat e rrjetit NGN (Next Generation Network); Protokollet e përdorura në rrjetin NGN; Softswitch-i.

Metodologjia e mësimdhënies:45 orë ligjërata dhe 15 ushtrime laboratorike. Afërsisht 60 orë pune të pavarur përfshirë punimin seminarik .

Vlerësimi:Vijueshmëria 10%, Vlerësimet intermediare 20 %, Provimi final 70 %

Literatura bazë:

1. S. R. Ali, “Digital switching systems (System Reliability and Analysis) ”, Bell Communication Research, Inc. Piscataway, New Jersey, McGraw-Hill, Inc, 1998
2. S. Lika, “Algoritme të telekomit – Centralet telefonike dixhitale ”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2002
3. R.Parkinson, “Traffic Engineering Techniques in Telecommunications”, Infotel System Corp.WhitePaper
4. R. Swale: “Voice over IP – Systems and solutions”, BT Communications Technology Series 3, 2008
5. Ericsson, “Understanding telecommunications “ , 2003

Titulli i kursit (lëndës): **Teknologjia e komunikimeve optike** (Me zgjedhje, sem. VI, 6 ECTS)

Qëllimi i kursit: Kursi merret me dukuritë themelore që lidhen me teknologjinë që mundëson transmetimin optik të informacionit.

Rezultatet e pritshme të nxënimit: Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje:

